

AKTI I THEMELIMIT
TË SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"INTERNATIONAL MEDICARE" SH.P.K

Themeluesi që nënshkruan më poshtë si vijon:

Bilal Kara, I biri I Behcetit, I datëlindjes 21.11.1980, lindur në Ankara dhe banues në Stamboll, Turqi, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar,

Që në vijim do të quhet ortak I vetëm I shoqërisë "INTERNATIONAL MEDICARE" SH.P.K

Sot më datën 05.04.2024, bazuar në vullnetin e tij të lirë dhe në përputhje me ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", vendosi të themelojë Shoqërinë Tregtare me Përgjegjësi të Kufizuar (më poshtë Shoqëria), në bazë të kushteve që vijojnë.

NENI 1

EMËRTIMI

Shoqëria emërtohet "INTERNATIONAL MEDICARE" SH.P.K.

NENI 2

SELIA E SHOQERISE

Shoqëria e ka selinë në: Tiranë, Njësia Bashkiake Nr.7, Zogu i Zi, Zona Kadastrale 8310, Nr.Pasurisë 6/1292.

NENI 3

KOHËZGJATJA


Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të pacaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit

NENI 4

OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Shoqëria "INTERNATIONAL MEDICARE" ka si object të veprimtarisë së saj:

Ofrimin e shërbimit spitalor jopublik. Investime dhe shërbime në fushën e mjeksisë dhe shëndetit, ngritja dhe menaxhimi i spitaleve dhe klinikave private, importimi dhe eksportimi i materialeve të ndryshme. Industria e ndërtimit, shitblerje, dhenie



ose marrje me qera. Riparim i paisjeve dhe puneve obliguese ne montim. Pergatitje projektesh. Konsulence teknike ne fushen e ndertimit dhe fusha te tjera, projektimi i pyjeve, etj. Tregtim me shumice te aparaturave mjekesore/paisje, tregtim me pakice i barnave. Konsulence dhe sherbime ne fushen e turizmit mjekesore. Marketingu, administrimi si dhe hapja e agjencive perkatese per sherbime te tilla. Import-eksport te prodhimeve dhe pjeseve te nderrimit si dhe aksesoreve me shumice e pakice per fushen e telekomunikacioneve, teknologjise, elektrike, elektronike etj. Projektim dhe konsulence teknike ne fushen e telekomunikacioneve, elektrikes etj. Import eksport, tregti me shumice e pakice te materialeve te ndertimit etj. Pergatitja e projekteve investuese dhe trajnime fizibilituese si dhe ti menaxhoje ato. Blerje pasuri te luajtshme dhe te paluajtshme etj. Te kryeje çdo lloj aktiviteti tregtar, financiar, dhenie-marrje me qira, te vendose pengje dhe barre 2 hipotekore; aktivitete keto te konsideruara si te dobishme apo te nevojshme per te arritur qellimet e shoqerise dhe qe nuk tejkalojne ne mase aktivitetet kryesore te cituara me siper. Tregtim te materialeve te ndryshme me pakice e shumice etj. Mbjellje dhe trajtim floku. Import-eksport te produkteve ushqimore, industriale, mjekesore apo farmaceutike, kozmetike, sipermarrja dhe sherbimi ne fushen e mjekesise, kirurgjive te ndryshme, ngritja e qendrave te ndryshme laboratorike/ekzaminime, estetike, klinika, spitale etj. Farmaci e rrjetit te mbyllur. Parking.

NENI 5

KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar shoqërisë ka vlerën 100 (njëqind) lekë dhe përfaqëson 1 kuotë.

Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tij të mëposhtëm:

1. Ortaku themelues Bilal Kara: zotërues I 1(një) kuote me vlerë të përgjithshme 100 (njëqind) lekë, që përbën 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

NENI 6


TRANSFERIMI I KAPITALIT

Pjesët e kapitalit themeltar te shoqërisë mund tu transferohen personave të tretë, që nuk bëjnë pjesë në shoqëri, vetëm pasi ato I janë ofruara më parë ortakëve të tjerë të saj dhe janë refuzuar për tu blerës prej tyre me cmimin e paraqitur zyrtarisht nga ortaku shitës.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirish të transferueshme ndërmejt ortakëve.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirish të transferueshme me rrugë trashëgimie.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirish të transferueshme edhe në rast ndarjeje pasurore mes bashëkshortëve, paraardhësve dhe pasardhësve



NENI 7

ADMINISTRIMI&KOMPETENCAT

1. Me këtë akt emërohet 1(një) administrator I shoqërisë, personi si më poshtë:
Z. Turan San, qytetar shqiptar, lindur në Turqi e banues në Tiranë, me nënshtetësi shqiptare, me numër personal G30816147T. Z. Turan San do të përfaqësojë shoqërinë në të gjithë veprimtarinë e saj për një periudhë 5 vjecare.
2. Administratori ka të drejtë e detyrim të:
 - a. Kryejë veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë;
 - b. Përfaqësojë shoqërinë tregtare;
 - c. Të pregatisë dhe nënshkruajë pasqyrat financiare vjetore dhe të propozojë shpërndarjen e fitimeve;
 - d. Është I autorizuar të veprojë në emër të shoqërisë në formim e sipër deri në regjistrimin e saj në qendrën kombëtare të biznesit.
 - e. Të kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe statut

NENI 8

GJUHA

Ky akt-themelimi u hartua në 4(katër)kopje në gjuhën shqipe, dhe pasi miratohet në parim dhe nen për nen nga Ortaku I vetëm i shoqërisë "INTERNATIONAL MEDICARE" Sh.P.K., nënshkruhet në të gjitha kopjet, duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmën origjinale.

Ortaku I Vetëm.

Bilal Kara

Bilal
KARA

